

VENDIM
Nr. 128, datë 25.6.2024

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “TIRANA ENERGJI” SHPK, PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE, PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, 7, 9, pika 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet, për dhënie e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 213/7 prot., datë 24.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., për dhënie e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., e licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 4.11.2020, me shkresën nr. 12 prot., datë 13.2.2024, protokolluar në ERE me nr. 213/2 prot., datë 13.2.2024, ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie.

- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, ERE iu drejtua shoqërisë, me shkresën nr. 213/3 prot., datë 23.2.2024, duke i evidentuar informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit të saj.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 213/4 prot., datë 29.4.2024, shoqëria ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për mospërgjigjen në kohë, për shkak të vonesës së marrjes së shkresës nga stafi administrativ dhe ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit u konstatua nevoja për plotësim të mëtejshëm të tij, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 213/5 prot., datë 27.5.2024.

- Në përgjigje, me shkresën nr. 213/6 prot., datë 31.5.2024, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar.

- Duke qenë se akti i kalimit të kuotave është nënshkruar përpara se të merrej autorizimi përkatës i ERE-s për këtë transferim, në ERE është depozituar deklarata e përbashkët e shitësit (ortakut të mëparshëm) dhe blerësit, dhe administratorit të shoqërisë (ortakut aktual), ku përcaktohet se kuotat do të kalojnë në gjendjen e mëparshme në rast të mosmarrjes së autorizimit nga ERE.

- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria me korrespondencën vijuese të realizuar me ERE-n, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k.

2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k. bëhet z. Bledar Hasalamaj.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti